

Në Kosovë kanë filluar të përdoren disa droga të reja kimike shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Përbërja e tyre variron nga substancat e përdorura në industri e deri te materialet për mirëmbajtje sanitare.

Rreth 1,200 persona në Kosovë janë përdorues të substancës narkotike të llojit heroinë, që njihet si njëra nga drogat më të dëmshme.

Drejtues të qendrës mediko-psikoterapeutike "Labyrinth" thonë se nuk ka rritje të përdorimit të kësaj droge.

Për udhëheqësin e kësaj qendre Safet Blakaj shqetësuese është futja në treg e llojeve të reja të drogave kimike që krijohen nga substancat të cilat përdoren në industri si dhe materiale për mirëmbajtje sanitare.

Në Evropë tashmë ekzistojnë 300 lloje të drogave kimike e disa prej tyre përdorën edhe në Kosovë tash e dy vjet, të cilat sipas Blakajt po përhapen shumë shpejt.

Këto lloje të drogave kimike janë substanca GHB e cila është akronim i formulës (Gama Hidor Galbulin) e që përmban elemente kimike siç janë zbardhuesit dhe pastruesit e ndryshëm të automjeteve.

Çmimi i këtyre drogave të reja është edhe më i lirë se sa marihuana.

Zyrtarë të Policisë së Kosovës thonë se kanë informacione për llojet e reja të drogës që përdorën në Kosovës, mirëpo deri më tani nuk kanë trajtuar asnjë rast./RTK/